



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **DWH KOSOVA**" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me instrument GPS** ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **DWH- KOSOVA**" SH.P.K. e dt.26.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me instrument GPS** ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 25.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 25.07.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.26.07.2023, Operatori Ekonomik " **DWH KOSOVA**" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "**Furnizim me instrument GPS** ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 31.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara sepse ju keni ofruar hapësire memorizuese te kontrollorit te antenes GNSS, ekstrem me te ulet se sa kërkesa e AK. Si dhe Sistemi operativ I ofruar nuk përputhet me Windows 10.

Ju sipas broshurave te ofruara ne dosjen e tenderit, për import / export të të dhënave keni ofruar vetëm DWG /DXF). Gjithashtu mungojnë edhe formatet tjera të të dhënave si: CSV, Shape File, TXT ( nëse ekzistojnë atëherë edhe këto formate te argumentohen përmes screenshot-ave ne softuerin e instrumentit).Edhe për Stacion Total nuk i keni plotësuar kërkesat e lartpërmendura për specifikat e kërkuara nga Autoriteti kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës